

KËRKESË PADI

PADITËS: **Rea Xhillari**, e bija e Thanasit dhe e Lindës,

Njoftimet mund të bëhen në adresën: Av.Alban Caushi, Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower, Nd.52, Kati 5.

I PADITUR: **Sali Berisha**, i biri i Ramës dhe i Shiqere, lindur më 01.07.1944, në Tropojë dhe banues në Tiranë, me adresë në Rruga “Mustafa Matohiti”, Ndërtesa 36, Hyrja 1, Njësia 2, Tiranë;

Luan Baçi, i biri i Ramadanit dhe i Hënës, lindur më 12.07.1963, në Gjirokastër dhe banues në Fier, me adresë njoftimi Kuvendi i Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4. Tiranë;

Flamur Noka, i biri i Dalifit dhe i Ajshes, lindur më 03.03.1971, në Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë njoftimi Kuvendi i Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4. Tiranë;

Tritan Shehu, i biri i Masarit dhe i Zanës, lindur më 24.04.1949, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë njoftimi Kuvendi i Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4. Tiranë;

Albana Vokshi, e bija e Sadikut dhe e Servetes, lindur më 24.02.1971, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë njoftimi Kuvendi i Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4. Tiranë;

Edi Paloka, i biri i Antoninit dhe i Tomaidhës, lindur më 23.12.1965, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë njoftimi Kuvendi i Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4. Tiranë;

Edmond Spaho, i biri i Shyqyriut dhe i Myneveres, lindur më 14.11.1958, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë njoftimi Kuvendi i Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4. Tiranë

Qendra për Informim të Hapur, në cilësinë e botuesit të portalit të lajmeve online **syri.net**, me NUIS L71603456N, Rr. Shyqyri Brari, Shk.4, Kati 1, Ap.2 (Pranë Kopshtit Botanik), Tiranë;

OBJEKTI: 1. Konstatimi i cenimit të personalitetit dhe reputacionit nga përhapja e thënieve të pavërteta me natyrë shpifëse.

2. Detyrimi i të Paditurve, **Sali Berisha, Luan Baçi, Edi Paloka, Tritan Shehu, Albana Vokshi, Flamur Noka** dhe **Edmond Spaho** që të shpërblejnë në mënyrë solidarë dëmin jo pasuror që më është shkaktuar në shumën 3.500.000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë së bashku me shpenzimet gjyqësore dhe të përfaqësimit.

3. Detyrimi i të Paditurit **Qendra për Informim të Hapur** të publikojë vendimin gjyqësor në të njëjtat kanale informimi ku janë përhapur dhe informacionet shpifëse të paditurve.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 48, 153 e vijues i Kodit të Procedurës Civile,
Nenet 608 – 647/a të Kodit Civil,
Nenet 3, 15/1, 17, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut

PËR KOMPETENCË

**Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm
Tiranë**

I Nderuar Z. Kryetar,

Unë, Paditësja **Rea Xhillari**, detyrohem të vë në lëvizje gjykatën për të ushtruar kontrollin gjyqësor, mbi një shpifje të fabrikuar ka kohë ndaj meje që e ka fillues në muajin gusht të vitit 2016, kur plot 8 vite më parë Sali Berisha më ka akuzuar se kam marrë pjesë dhe kam përfituar tendera publikë. Sipas individit për të cilin kërkoj kontroll gjyqësor, këta tendera i kam përfituar “nëpërmjet subjektit tregtar 51N4E”, që në fakt është një studio arkitekture me qendër në Bruksel. Përgjatë këtyre 8 viteve, Sali Berisha ka vijuar në mënyrë të herëpashërshme të përgojë në publik emrin tim, duke më asociuar arbitrarisht me aktivitete, individë dhe përfitime pa asnjë lidhje me mua.

Në këto 8 vite, kam gjykuar që shpifjet publike ndaj meje, të konsumuara nga ana e përgojuesit tim në terrenin politik e publik, nuk meritojnë përfshirjen time. Kjo sepse së pari, nuk kam zgjedhur politikën si fushë të interesit tim dhe nuk jam jo vetëm faktor i drejtëpërdrejtë, po as i tërthortë i debatit politik. Së dyti, sepse Sali Berisha është shpallur "shpifës" me vendim gjykate në shumë raste dhe më është dukur sikur durimi ishte më i arsyeshëm se sa denoncimi i një personazhi që shpifjen e ka natyrë të dytë. Së fundi, sepse ky personazh nuk ka pushuar së

shënjestruari, godituri dhe përbalturi nënën time, Linda Ramën, nga momenti që ajo zgjodhi të ishte bashkëshorte e Edi Ramës. Linda, nëna ime, është shembulli im i qytetarisë dhe profesionalizmit, modeli i përkushtimit familjar dhe dinjitetit publik. Dikush që nuk meriton përgjigjen e Lindës, nuk mundet kurrsesi të meritojë as timen.

Por shpifjet e 8 viteve ndaj meje, në datën 10 qershor 2024, nëpërmjet një kërkesë shkresore u transportuan nga hapësira e dalldisë politike, në institucionin ligjvënës të vendit tim. Nga mendjet trilluese ato u zyrtarizuan me bojën e firmave të shtatë deputetëve të Parlamentit të Shqipërisë, të cilët me mandatin e tyre të përfaqësimit të qytetarëve përfshinë emrin tim në një kërkesë marrjeje në pyetje të kryeministrit të vendit.

Konkretisht, në datën 11. 06. 2024 në edicionin informativ të shfaqur pranë ofruesit të shërbimit audioviziv me licencë “Syri TV” është bërë e njohur publikisht një kërkesë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për interpelancë parlamentare me Kryeministrin Edi Rama (Kërkesë për Interpalancë Urgjente me Kryeministrin Edi Rama Nr. 2319 Prot. datë 10.06.2024) e nënshkruar nga të Paditurit Sali Berisha, Luan Baçi, Flamur Noka, Tritan Shehu, Albana Vokshi, Edi Paloka, Edmond Spaho, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike. Në kërkesën për interpelancë, të paditurit prej meje i kanë paraqitur Kuvendit dhe publikut fabulën e rreme të përfshirjes sime në veprimtari të paligjshme.

Sipas tyre, kam “*marrë pjesë dhe përfituar tendera publike, pa figuruar pronare e drejtpërdrejte, por e lidhur me subjekte tregtare dhe si bashkëpunëtore e tyre, kam përfituar vlera të konsiderueshme monetare prej tyre*”,

kam “*përfituar nëpërmjet subjektit tregtar 51N4E, e cila rezulton të jetë një studio projektimi dhe konsulence me qendër në Bruksel dhe Tiranë, ku nga verifikimi në faqen zyrtare të këtij subjekti rezulton se kam qenë pjesë e stafit dhe bashkëpunëtore për shumë vite*”.

kam “*fshehur përfitimet e drejtpërdrejta që vinin nga pjesëmarrja në kontrata publike të subjektit 51N4E*”,

kam “*përfituar nga tenderat publike edhe nëpërmjet subjektit tregtar “I RI” sh.p.k., bashkëthemeluar nga shtetasi Gent Agolli dhe subjekti 51N4E*”.

Më tej, të Paditurit shprehen me një siguri mbresëlenëse se si dy subjektet tregtare “51N4E dhe I RI të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shtetasen Rea Xhillari (pra me mua) kanë përfituar kontrata publike në vlerën 2.9 miliardë lekë. Shtuar këtyre kontratave publike, subjektet e lidhura me shtetasen Xhillari (pra përsëri me mua) rezultojnë edhe fituese të konkurseve për ndërtimin e kullave në qendër të Tiranës, për të cilat thjeshtri i saj Edi Rama ka firmosur lejet e zhvillimit/ndërtimit”.

Po këta të paditur, i shpjegojnë vullnetet e shitblerjeve pronësore midis individësh pa asnjë lidhje me mua, si "*një përpjekje e pasuksesshme e imja për të fshehur përfitimet e drejtpërdrejta që vinin nga pjesëmarrja në kontrata publike të subjektit 51N4E*".

Kjo mori paragrafësh trillues, të shkruar me një gjuhë të ulët në çdo drejtim, më ka detyruar t'i lexoj dhe koleksionoj për këtë padi gënjeshtat e firmosura nga persona të paftuar e të padëshiruar në jetën time.

Këto deklarime të rreme dhe tejet të rënda nga ana e të paditurve në drejtimin tim, janë një ndërhyrje kriminale në jetën time dhe i shërbejnë qëllimit të denigrimit pa asnjë provë të personit tim. Ato bëhen për të krijuar në publik imazhin e një personi përfitues nga afërsia familjare me kundërshtarin e tyre politik, përmes veprimtarish të cilat nëse do të ishin të vërteta, do të ishin objekt për organet e ndjekjes penale. Këta të paditur solidarë mbi bazë shpifjeje e në cenim të nderit, dinjitetit, personalitetit dhe reputacionit tim, janë futur brutalisht në jetën time private.

Z. Kryetar,

E vërteta ime është kjo: unë kam ndjekur studimet universitare ne Accademia di Architettura di Mendrisio në Zvicër. Pjesë e detyrimit akademik për çdo student, ishte kryerja e praktikës mësimore (internshipit) pranë një studjoe projektimi dhe të gjithë studentët aplikonin pranë studiove të kësaj natyre në Europë. Për të kryer Praktikën time Mësimore (apo Stazhin), kam aplikuar në studion e projektimit 51N4E në Belgjikë. Aplikimit tim për t'u pranuar si studente praktikante për një periudhë 9 mujore, kjo studio i është përgjigjur pozitivisht në Shtator të vitit 2011 (Nënvizoj se Edi Rama në atë moment nuk mbante asnjë funksion zyrtar ndërsa unë isha thjesht një studente).

Programi i praktikës mësimore është kryer në periudhën 01/10/2011 – 30/06/2012, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së nënshkruar midis meje dhe studios 51N4E (kopja e noterizuar bashkëngjitur). Kontrata përcakton që internshipi është detyrim i kurrikulës mësimore të studentit dhe është pa shpërblim financiar për studentin. Në përfundim të Praktikës Mësimore Studio 51N4E ka dorëzuar në Universitet Certifikatën e Kryerjes së Praktikës nga ana ime me të gjithë informacionet e nevojshme (kopja e noterizuar bashkëngjitur). Përgjatë praktikës, sëbashku me ekipin e studios 51N4E dhe studentë të tjerë në proces internshipi, jam përfshirë dhe kam kontribuar në kryerjen e detyrave të ndryshme duke merituar në fund, sipas standardeve të çdo kodi modern pune emrin "bashkëpunëtor" si njohje e këtij kontributi. Është pikërisht, cilësimi i statusit "bashkëpunëtor" ai që është keqpërdorur qëllimisht dhe vijimisht nga ana e të Paditurve solidarë. Me këtë rast i kujtoj secilit prej tyre, që duke keqpërdorur për shpifje të ulëta statusin e merituar "bashkëpunëtor" për punën e pa paguar gjatë praktikës mësimore nga ana ime, ata kanë pranuar në subkoshiencën e tyre që një student praktikant sipas tyre është thjeshtë një skllav i kohëve moderne. Është e pabesueshme që kjo të jetë llogjika e të menduarit e shtatë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë të vitit 2024.

Më tej, nënvizoj që marrëdhëniet e mia kontraktuale me studion e projektimit 51N4E janë mbyllur plotësisht në vitin 2012. Më pas, në asnjë rast, aktiviteti im profesional nuk ka patur asnjë pikë takimi me studion e projektimit 51N4E.

Ndërsa shtetasin Gent Agolli (dhe për rrjedhojë dhe subjektin tregtar "I RI"), cituar në kërkesën për interpelancë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë nga ana e të Paditurve solidarë, unë as nuk e njoh personalisht dhe as e kam takuar kurrë ndonjëherë, qoftë dhe rastësisht.

Z. Kryetar,

Disa vite më parë kam paditur Z. Artur Zheji dhe 7 të tjerë nga bota e medias pasi, nëpërmjet lajmit të rremë në mediat e tyre, po për interesa politike dhe po si vajza e Linda Ramës, më caktuan si bashkëshort një person që as nuk e njihja e as e kisha takuar kurrë në jetë. **Gjykata i gjeti fajtorë.** Të Paditurit solidarë të Kuvendit të Shqipërisë, në kërkesën e tyre për interpelancë me Kryeministrin Edi Rama, kanë sajuar një identikit timin pa kurrëfarë lidhje me mua dhe kanë marrë përsipër të më caktojnë nëpërmjet shpifjes si partner profesional një individ plotësisht të panjohur për mua.

Zoti Kryetar,

Unë nuk kam asnjë armë tjetër për t'u mbrojtur nga pasojat e këtij perversiteti politik, social dhe ligjor, përveçse duke i'u drejtuar drejtësisë.

A. LEGJITIMI, JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCA

Nenin 32 germa "a" të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se "*Padia mund te ngrihet: Për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur*". Nga ana tjetër, të Paditurit mbajnë përgjegjësi të plotë për deklaratimet e tyre në kuadër të legjislacionit shqiptar në fuqi. E në fakt, Deklarata objekt gjykimi është bërë në shkelje të ligjit, më pasojë cenimin e interesave të Paditësit të mbrojtura e garantuara me ligj, duke e legjitimuar atë plotësisht lidhur me objektin e padisë.

Bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Sipas nenit 41 të Kodit të Procedurës Civile janë në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë të gjitha mosmarrëveshjet civile e mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të tjera. Po ashtu, neni 48 (1) parashikon se paditë që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku ka banim i padituri ashtu edhe në gjykatën e vendit ku është shkaktuar dëmi.

Sa më sipër, bazuar në nenet 35, 36(1), 41 dhe 48(1) të Kodit të Procedurës Civile, çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

B. LIGJI I ZBATUESHËM

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, qysh në preambulën e saj, angazhohet “*për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor*”, gjë që reflektohet në të gjitha parimet e normat e saj. Po ashtu, neni 3 i saj parashikon se *dinjteti i njeriut është i vendosur në krye të arsyeve të vetë ekzistencës dhe të bazave të shtetit shqiptar*, i ndërtuar dhe i angazhuar, si çdo shoqëri tjetër demokratike bashkëkohore, me synimin për të *njohur dhe respektuar rigorozisht shtetin e së drejtës*.

Nga ana tjetër, Neni 625 i Kodit Civil parashikon *shpërblimin e dëmit jopasuror kur është cenuar nderi, personaliteti dhe reputacioni i një personi*.

E në fakt, deklarimi publik e me faj i thënieve shpifëse e fyese mbi fakte konkrete në drejtimin tim: “... *faktin se shtetasja Rea Xhillari, e bija e zonjës Linda Rama, bashkëshortes së kryeministrit Edi Rama, ka marrë pjesë dhe përfutuar tendera publike, pa figuruar pronare e drejtpërdrejte, por e lidhur me subjekte tregtare dhe si bashkëpunëtore e tyre, ka përfutuar vlera të konsiderueshme monetare prej tyre. Konkretisht, shtetasja Xhillari ka përfutuar nepermjet subjektit tregtar 51N4E, e cila rezulton të jetë një studio projektimi dhe konsulence me qendër në Bruksel dhe Tirane, ku nga verifikimi në faqen zyrtare të këtij subjekti rezulton se Rea Xhillari ka qenë pjesë e stafit dhe bashkëpunëtore për shumë vite.*

..., shtetasja Xhillari ka përfutuar nga tenderat publikë edhe nëpërmjet subjektit tregtar “I RI” sh.p.k., i cili është bashkëthemeluar nga shtetasi Gent Agolli dhe subjekti 51N4E. ...

Mungesa e logjikës tregtare në kryerjen e këtij veprimi mund të shpjegohet vecse një përpjekje e pasuksesshme e shtetases Rea Xhillari për të fshehur përfitimet e drejtpërdrejta që i vinin nga pjesëmarrja në kontrata publike të subjektit 51N4E. ... të dy këto subjekte tregtare të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shtetasen Rea Xhillari kanë përfutuar kontrata publike në vlerën 2.9 miliardë lekë , subjektet e lidhura me shtetasen Xhillari rezultojnë edhe fituese të konkurseve për ndërtimin e kullave në qendër të Tiranës, për të cilat thjeshtri i saj Edi Rama ka firmosur lejet e zhvillimit/ndërtimit , për të kuptuar fiktivitetin e shoqërisë “I RI” sh.p.k. dhe se si ajo është krijuar vetëm si një përpjekje për të kamufluar përfshirjen dhe përfitimet e shtetases, Rea Xhillari mungesa e logjikës tregtare shpjegohet dhe lidhet vetëm me emrin e Rea Xhillarit, thjeshtres së kryeministrit Edi Rama”, pa asnjë provë të organeve të ngarkuara me ligj për këtë qëllim, provojnë në mënyrë vetëshpjeguese e në çdo gërmë të tyre cenimin e nderit, personalitetit dhe reputacionit tim, duke më pozicionuar në situata e rrethana që

kërkojnë vendosjen në vend të të drejtës së shkelur nga aktet shkelëse sipas parimit të barzvllefshmërisë së dëmshpërblimit.

E në fakt, Deklarata shkel në mënyrë flagrante çdo parim të qasjes personale të një personi ndaj një tjetri duke plotësuar katërcipërisht edhe kërkimet e neneve 608 e 609 të Kodit Civil për shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor e pikërisht se:

- *Veprimi i kundërligjshëm*

Veprimi i paligjshëm në shkaktimin e dëmit cilësohet një kategori objektive, shfaqja e kundërligjshme e vullnetit të subjektit të se drejtës që sjell si pasoje shkeljen ose cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave të të tretëve që mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira.

Kundërligjshmëria e sjelljes së subjektit shkaktar të dëmit cënon marrëdhëniet juridike, që gëzojnë mbrojtje nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare, ligjet dhe aktet nënligjore, të cilat njohin dhe garantojnë të drejtat e personave fizik dhe juridik në raport me njëri-tjetrin dhe pushtetin publik.

Veprimi i bërë nga të Paditurit nëpërmjet Deklaratës është i kundërligjshëm, pasi ai haptazi konsiston në deformimin e qëllimshëm, përdorimin, publikimin e përhapjen nga të Paditurit, e fjalëve apo shprehjeve të pavërteta (shpifëse) dhe fyese, me pasojë cenimin e nderit, personalitetit dhe reputacionit të Paditëses të mbrojtura nga rendi juridik.

Veprimi i të Paditurive nëpërmjet Deklaratës cenon marrëdhëniet juridike të mbrojtjes së nderit, dinjitetit dhe personalitetit të personit të cilat sanksionohen e garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 8) e ligjet të cilat garantojnë mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor.

Deklarata përmban një shumësi elementësh paligjshmërie që manifestohen në mënyrë flagrante në shprehjet e rreme dhe fyese: ... **... faktin se shtetasja Rea Xhillari, e bija e zonjës Linda Rama, bashkëshortes së kryeministrit Edi Rama, ka marrë pjesë dhe përfutuar tendera publike, pa figuruar pronare e drejtpërdrejte, por e lidhur me subjekte tregtare dhe si bashkëpunëtore e tyre, ka përfutuar vlera të konsiderueshme monetare prej tyre. Konkretisht, shtetasja Xhillari ka përfutuar nëpërmjet subjektit tregtar 51N4E, e cila rezulton të jetë një studio projektimi dhe konsulence me qendër në Bruksel dhe Tirane, ku nga verifikimi në faqen zyrtare të këtij subjekti rezulton se Rea Xhillari ka qenë pjesë e stafit dhe bashkëpunëtore për shumë vite.**

... shtetasja Xhillari ka përfutuar nga tenderat publikë edhe nëpërmjet subjektit tregtar "I RI" sh.p.k., i cili është bashkëthemeluar nga shtetasi Gent Agolli dhe subjekti 51N4E. ...

Mungesa e logjikës tregtare në kryerjen e këtij veprimi mund të shpjegohet vecse një përpjekje e pasuksesshme e shtetases Rea Xhillari për të fshehur përfutimet e drejtpërdrejtë që i vinin nga pjesëmarrja në kontrata publike të subjektit 51N4E. ... të dy këto subjekte tregtare të

lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shtetasen Rea Xhillari kanë përfituar kontrata publike në vlerën 2.9 miliardë lekë , subjektet e lidhura me shtetasen Xhillari rezultojnë edhe fituese të konkurseve për ndërtimin e kullave në qendër të Tiranës, për të cilat thjeshtri i saj Edi Rama ka firmosur lejet e zhvillimit/ndërtimit , për të kuptuar fiktivitetin e shoqërisë “I RI” sh.p.k. dhe se si ajo është krijuar vetëm si një përpjekje për të kamufluar përfshirjen dhe përfitimet e shtetasës, Rea Xhillari mungesa e logjikës tregtare shpjegohet dhe lidhet vetëm me emrin e Rea Xhillarit, thjeshtërës së kryeministrit Edi Rama” që përbëjnë një akt të pashembullt të qasjes ndaj një personi tjetër.

Po ashtu, shprehjet shpifëse e fyese e të Paditurve, në kontekstin që janë thënë, marrin vlerën e të vërtetës dhe i drejtohen publikut dhe opinionit të gjerë shoqëror duke i bërë thëniet të përbotshme, i drejtohen direkt Paditëses e me një akuzë të drejtpërdrejtë në trajtën e faktit të kryer, pa paraqitur asnjë provë të vetme për këtë qëllim.

Është po GJEDNJ që lidhur me këtë parametër është shprehur se “ *fakti i të akuzuarit direkt të individëve të veçantë, duke përmendur emrat dhe pozicionet e tyre, i vendos aplikantët (aplikantët në këtë vendim të GJEDNJ kanë qenë të paditur për shpifje në shtetin e tyre) nën detyrimin për të siguruar një bazë faktike të mjaftueshme për pohimet e tyre.*” (shih Vendimin e GJEDNJ *Cumpănă dhe Mazăre v. Rumanisë*, nr. 33348/96, §101, *Lešník v. Sllovakisë*, nr. 35640/97, § 57, apo *Vides Aizsardzības Klubs v. Letonisë*, nr. 57829/00, § 44).

Edhe nëse do të merrnim parasysh argumentimin se faktet e pretenduara për të vërteta qenkëshin thjesht opinione, po ashtu, jurisprudenca evropiane ka arritur në konkluzionin se, citohet: “ *në parim nuk është e papajtueshme me nenin 10 të Konventës (liria e shprehjes) për ta kaluar tek i padituri, në procedimet për shpifje, barrën për të provuar mbi një standard civil të arsyeshëm prove, që deklaratat diskredituese ishin në thelb të vërteta.*” (shih vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Europapress Holding D.O.O. v Kroacisë*).

E në fakt, edhe GJEDNJ ka konkluduar në mënyrë të përsëritur se edhe deklaratat që janë thjeshtë opinione duhet të bazohen mbi një bazë faktuale (Shih Vendimi: *PETRINA v. ROMANIA*, kërkesa nr. 78060/01, Vendim date 14 tetor 2008, paragrafët 49 -50). Në këtë rast GJEDNJ, ka pohuar se: “*...Edhe nëse pranohet se deklaratat në fjalë mund të konsiderohen si thjeshtë opionine, Gjykata konsideron se ato nuk kanë ndonjë bazë faktike*”. “ *Nuk kishte asnjë indicie që Paditësi ka punuar si agjent i Sekuritate; dhe përgjigjja zyrtare e C.N.S.A.S., në vitin 2004, gjithashtu ka konfirmuar mungesën e ndonjë përfshirje të paditësit në strukturat e Securitate”*

I njëjti koncept është përsëritur nga GJEDNJ në rastin *Ivanciuc* (Shih Vendimin: *IVANCIUC v. ROMANIA*, kërkesa nr. 18624/03, Vendimi date 8 shtator 2005 , paragrafi 98-101), citohet:

“.....Është e vërtetë se, në kontekstin e pretendimeve lidhur me sjelljen e një pale të tretë, ndonjëherë mund të jetë e vështirë të bëhet dallimi midis deklaratave të fakteve dhe opinionëve. Megjithatë, kjo nuk e ndryshon faktin se kur atribuohen fakte specifike një individit të përcaktuar duhet të ekzistojë një baza faktike e mjaftueshme për deklaratën objekt gjykimi, pasi edhe një vlerësim/opinion pa ndonjë bazë faktike për ta mbështetur atë mund të konsiderohet i tepruar”.

Një tjetër vendim ku GJEDNJ nënvizon faktin se edhe opinionet ose gjykimet subjektive duhet gjithsesi të kenë një bazë faktike është ai shprehur për çështjen Mengi kundër Turqisë (Shih Vendimin: MENGI v. TURKEY kërkesa n. 13471/05 e 38787/07, Vendimi datë 21.11.2012, paragrafë 49, 57, 58). Në këtë vendim GJEDNJ, ka theksuar se: “..Megjithatë, edhe kur një deklaratë përbën një gjykim subjektiv, duhet të ekzistojë baza e mjaftueshme faktike, pa të cilin ajo deklaratë do të konsiderohet e tepruar.”

Po kështu kjo gjykatë (GJEDNJ) kur ka bërë dallimin midis deklaratave të faktit dhe gjykimeve vlerësuese shprehet: “se edhe nëse një deklaratë përbën një gjykim vlerësues (opinion), përpjestimi i ndërhyrjes mund të varet nga fakti nëse ekziston ose jo një bazë të mjaftueshme faktike për deklaratën e kundërshtuar, për shkak se edhe një gjykim vlerësues pa asnjë bazë faktike që e mbështet atë mund të jetë i tepërt” (shih vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Lingens v Austrisë).

E në fakt, në gjykimin civil dhe në të drejtën e detyrimeve (sa i përket pjesës së shkaktimit të dëmit), në dallim nga e drejta penale, vlen **parimi i prezumimit të fajësisë**.

Jurisprudenca e GJEDNJ si dhe jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatave Shqiptare bazuar në Vendimin Unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (më poshtë referuar edhe si “VUGJL 12”) kanë sqaruar në mënyrë të posaçme se, në rastin e gjykimit për dëmin jopasuror “Nga gjykata duhet të pranohet (ius receptum) si e vërtetuar ligjërisht, me anë të prezumimeve të thjeshta, pretendimi i paditësit se i është shkaktuar dëm jopasuror. Në këtë lloj gjykimi, i mbetet të paditurit barra e provës të vërtetojë të kundërtën, përndryshe, kërkimet e paditësve **çmohet se janë vërtetuar**”.

Deklarata e të Paditurve objekt gjykimi e cila i referohet akuzave publike për attribute konkrete të rreme e fyese që cenojnë nderin dhe personalitetin e Paditëses, është kryer tërësisht e deklarativisht nga vetë palët e Paditura e pambështetur apo referuar në asnjë provë të vetme.

Në këto kushte e për shkak të standardid ligjor të stabilizuar qysh në vitin 2007, në kuptim të VUGJL 12, nëse i Padituri nuk provon bazën faktike të deklaratimeve të tyre publike referuar fakteve të pretenduara për të vërteta, kërkimi im për cenim të nderit, personalitetit dhe reputacionit për shkak të thënieve të rreme (shpifëse) çmohen të vërtetuara.

T'i atribuosh dikujt veprime të paqena që për më tepër përbëjnë deri vepra penale duke cenuar reputacionin e të tretëve, përbën cenim të nderit, dinjtetit, integritetit dhe personalitetit në kuptim të nenit 625 të Kodit Civil.

Të Paditurit mbajnë përgjegjësi të plotë për deklaratimet e tyre shpifëse apo që cenojnë dinjtëtin e personalitetin e njeriut, duke mos gëzuar asnjë privilegj apo mbrojtje nga legjislacioni në fuqi. Në fakt, neni 73/1 të Kushtetutës së Shqipërisë, përcakton qartë se: "*Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit... Kjo dispozite nuk zbatohet për rastin e shpifjes*".

Nga ana tjetër duke iu referuar nenit 626 të Kodit Civil, të paditurit përgjigjen solidarisht ndaj të dëmtuarit kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku.

- *Faji i personit që shkakton dëmin*

Faji është qëndrimi subjektiv i personit shkaktar të dëmit në raport me veprimin e kundërligjshëm dhe pasojat që vijnë prej tij, që nënkupton vullnetin e brendshëm psikik për të kryer veprimin, për të siguruar ardhjen e pasojave ose lejimin e ardhjes së tyre.

Faji nënkupton kryerjen e veprimit të paligjshëm me dashje apo nga pakujdesia. Në këtë rast, përhapja e informacionit të rremë në formën e shpifjes dhe fyerjes nga të Paditurit për personin tim, është bërë me dashje të plotë.

Po ashtu, në mënyrë të arsyeshme nga pikëpamja e ndërgjegjes dhe rëndësisë së veprimit, apo edhe mjetit të përdorur për publikimin e shprehjeve të veta shkelëse, palët e Paditura kanë qenë në mënyrë deklarative qëllimisht të vetëdijshme për dëmin që do më shkaktonin nga veprimi i tyre i kundërligjshëm.

E më tej, edhe përdorimi i mediave audiovizive dhe i internetit për përhapjen e gjerë të deklaratës, provon synimin dhe qëllimin e qartë të Paditurve për të goditur personin tim me qëllim final cenimin e nderit personalitetit dhe reputacionit, për qëllime tërësisht personale.

- *Lidhja e drejtpërdrejtë dhe e menjëhershme mes veprimit dhe dëmit të shkaktuar*

Elementi i lidhjes shkakësore mbështetet në parimin *condicio sine qua non* sipas të cilit nuk do të vërtetohej ardhja e pasojës nëse nuk do të kishte ndodhur shkakun, sjellja e paligjshme dhe faji për shkaktimin e dëmit.

Pra, nëse nga njëra anë vërtetohet sjellja e paligjshme dhe faji në formën e dashjes së plotë në rastin e publikimit të Deklaratës objekt gjykimi, është vetë kërkimi sipas kësaj kërkesë padie që konfirmojnë pa ekuivok nevojën që Paditësja ndjen për të vendosur në vend dinjtëtin e shkelur

dhe rekuperimin e dëmtimit të brendshëm të shkaktuar drejtpërdrejt nga përhapja e qëllimshme, me dashje dhe faj e një informacioni të rremë nga ana e të Paditurve në dëm.

- *Ekzistenca e dëmit*

Neni 625 i Kodit Civil parashikon përgjegjësinë për dëmin jopasuror në rastin e cenimit të nderit dhe personalitetit të individit.

Deklarata e të Paditurve cenon haptazi dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, nderin, integritetin dhe personalitetin e Paditëses, pasi krijon fabulën mashtruese se unë paskam: *“marrë pjesë dhe përfituar tendera publike, pa figuruar pronare e drejtpërdrejte, por e lidhur me subjekte tregtare dhe si bashkëpunëtore e tyre, ka përfituar vlera të konsiderueshme monetare prej tyre”, “fshehur përfitimet e drejtpërdrejta që i vinin nga pjesëmarrja në kontrata publike të subjektit 51N4E”, “subjektet e lidhura me shtetasen Xhillari rezultojnë edhe fituese të konkurseve për ndërtimin e kullave në qendër të Tiranës, për të cilat thjeshtri i saj Edi Rama ka firmosur lejet e zhvillimit/ndërtimit”,* fakte këto të rreme të cilat krijojnë efekt të jashtëzakonshëm cenes për personin tim.

Përmbajtja e tejet e ulët e Deklaratës është një sulm keqdashës që pavarësisht qëllimit për të cilin është formuluar dhe publikuar, cenon drejtpërdrejt nderin, integritetin, personalitetin dhe besueshmërinë e personit tim në shoqëri.

Ekzistenca e dëmit provohet jo vetëm nga pathemeltësia e Deklaratës por edhe vetë reagimi im ndaj saj, që po kulmon me paraqitjen e kësaj kërkesë padie ne gjykatë çka konfirmon cenimin e brendshëm e nevojën imediate për të rivendosur në vend dëmin e pësuar.

- *Masa e dëmit*

Deklarimet e kundërligjshme të të Paditurve në adresë time më kanë shkaktuar një dëm konkret jopasuror, i cili konsiston në dëmtimin e nderit dhe personalitetit tim dhe si një dëm i pësuar në sferën personale, profesionale e shoqërore.

Në përputhje me Nenin 647/a të Kodit Civil shpërblimi i dëmit jopasuror të shkaktuar nga Deklarimet e të Paditurve për shkak të cenimit të nderit, personalitetit ose reputacionit tim, duhet të rivendosë të drejtën e shkelur, në mënyrë proporcionale me dëmin e pësuar (parimi i barazvlefshmërisë së dëmshpërblimit).

Masa e dëmit të kërkuar determinohet nga një sërë rrethanash rënduese të parashikuara nga vetë dispozita e mësipërme si:

- i) *mënyra dhe mjeti i përdorur për publikimin e veprimit të kundërligjshëm nga i Padituri dhe shpërndarja e këtij lajmi* (Deklarata është shpërndarë nëpërmjet kanalit te televizionit

Syri TV, syri.net dhe platformës youtube e njohur si platformë me shpërndarjen, aksesueshmërinë e lexueshmërinë të madhe në botë);

- ii) *shkelja e tejskajshme i rregullave të etikës së komunikimit nga të Paditurit (sulmohet një person në mënyrë të paprecedentë në shkelje flagrante të çdo principi bazë të qasjes apo sjelljes në shoqëri si respekti, e drejta apo e vërteta. Krijohet e hidhet për konsum një fabul e rreme e përbërë nga akuza penale me qëllimin e vetëm të linçimit të mesazheve inkriminuese mbi fakte konkrete madje duke mashtruar publikun se ato çfarë deklarohet janë të bazuara në prova);*
- iii) *goditja haptazi me faj e me qëllimin e qartë për të më denigruar në sy të opinionit publik me vetëdije të plotë për pathemeltësinë e deklarimeve të tyre (sulmohem drejtpërdrejt mbi argumente tejet të dobëta duke më konsideruar e përfshirë në sjelljet më kriminale të imagjinueshme, fabul që ndodhet e gjitha në mendjen e të Paditurve e hidhet si fakt ndaj meje për konsum publik me qëllimin e dashjen e posaçme që publiku ta konsiderojë atë të pa asnjë dyshim të vërtetë).*
- iv) *mosmarrja fare parasysh e çfarëdo standardi sjellje sa kohë jo vetëm që nuk verifikon por përhap pa ndalim thënie të pavërteta (të Paditurit me vetëdije e me qëllim kanë përhapur në publik fakte të rënda që, për vetë natyrën e gravitetin e tyre, meritojnë të rikonfirmohen edhe nga Gjykata si shprehje klasike të cenimit të çdo standardi sjelljeje);*
- v) *pavërtetësia e fakteve pretenduara me pasojë cenimin e nderit personliteti dhe reputacionit tim me pasojë cënimin e jetës private por edhe të sferës së veprimtarisë publike ku unë kontribuoj (është në qëllimin e tyre, e në fakt, të Paditurit deklarojnë se unë qenkësha një person e cila marr pjesë dhe përfitoj tendera publike, pa figuruar pronare e drejtpërdrejte, por e lidhur me subjekte tregtare dhe si bashkëpunëtore e tyre, ka përfitur vlera të konsiderueshme monetare prej tyre”, “fshehur përfitimet e drejtpërdrejte që i vinin nga pjesëmarrja në kontrata publike të subjektit 51N4E”, “subjektet e lidhura me shtetasen Xhillari rezultojnë edhe fituese të konkurseve për ndërtimin e kullave në qendër të Tiranës, për të cilat thjeshtri i saj Edi Rama ka firmosur lejet e zhvillimit/ndërtimit, pa asnjë pikë prove, duke shkaktuar një dëm eksponencial e çoroditur, shkurajuar e cenuar besimin e çdo mendje normale në qasjen ndaj kreut të ekzekutivit në këtë vend).*
- vi) *Fakti që pjesa më e madhe e të Paditurve që kanë përhapur deklaratat me natyrë shpifëse janë të dënuar dhe më parë për shpifje dhe ndërshekimet që kanë marrë nga Gjykatata nuk kanë luajtur rol korrektues është rrethanë rënduese dhe duhet të merret parasysh nga gjykatat në caktimin e masës së dëmshpërblimit që duhet të më paguajnë.*

Graviteti i deklarimeve të fakteve të Deklaratës që nga njëra anë më atribuojnë veprime –*person e cila marr pjesë dhe përfituar tendera publike, pa figuruar pronare e drejtpërdrejte, por e lidhur me subjekte tregtare dhe si bashkëpunëtore e tyre, ka përfituar vlera të konsiderueshme monetare prej tyre*”, “*fshehur përfitimet e drejtpërdrejta që i vinin nga pjesëmarrja në kontrata publike të subjektit 51N4E*”, “*subjektet e lidhura me shtetasen Xhillari rezultojnë edhe fituese të konkurseve për ndërtimin e kullave në qendër të Tiranës, për të cilat thjeshtri i saj Edi Rama ka firmosur lejet e zhvillimit/ndërtimit, të cilat do të përbënin akuza penale për çdo qytetar të thjeshtë edhe fakti që vetë të Paditurit deklarojnë se kanë prova, në anën tjetër passjellin rritjen shumëfish të rrezikshmërisë së veprimit të kundërligjshëm si dhe të dëmit shumëfish e të parikuperueshëm që më shkaktohet.*

Deklaratës me përmbajtje shpifëse i ka dhënë përhapje të metejshme publike i padituri tjetër, Qendra për Informim të Hapur, e cila me anë të medias audiovizuale por dhe kanalet digjitale në youtube por dhe platforma syri.net ka mundësuar përhapjen e deklaratave shpifëse të të paditurve.

PROVAT

Parashtröjmë në vijim listën e provave në mbështetje të padisë:

1. Kërkesë për Interpelancë Urgjente me Kryeministrin Edi Rama Nr. 2319 Prot. datë 10.06.2024
2. Publikimet ne linkun:
 - <https://www.syri.net/politike/696231/syri-tv-berisha-kerkon-interpelence-urgjente-me-ramen-prova-qe-rea-xhillari-perfitoi-33-pagesa/>
 - <https://www.youtube.com/watch?v=qtjbn4hLldY>
3. Marrëveshje Për Praktikën Mësimore datë 15.09.2011;
4. Certifikatë e përfundimit të praktikës mësimore datë 30.06.2012;

* * * * *

Për sa më sipër, bazuar në nenet 31, 32, 48, 153, 154, 154/a të Kodit të Procedurës Civile, dhe Neneve 608 - 647/a të Kodit Civil,

Ju kërkoh

1. Pranimin e kërkesë padisë;

2. Detyrimin solidar e të Paditurve Sali Berisha, Luan Baçi, Edi Paloka, Tritan Shehu, Albana Vokshi, Flamur Noka dhe Edmond Spaho të më shpërblejnë dëmin jo pasuror që më kanë shkaktuar në shumën 3.500.000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë.
3. Detyrimi i të Paditurit Qendra për Informim të Hapur të publikojë vendimin gjyqësor në të njëjtat kanale informimi ku janë përhapur dhe informacionet shpifëse të paditurve të tjerë
4. Shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit në ngarkim të të Paditurve.

PADITËS

Rea Xhillari

Përfaqësuar me prokurë nga Av. Alban Caushi¹

Tiranë, më 10 Korrik 2024

¹ Prokurë e Posacme Nr. Rep. 2596 dhe Kol. 684, datë 27.6.2024